Faqe 33 – Fotografi, *Burgi shpuese dheu vertikale - ky dokument nuk është kërkuar në DT.*

Faqe 34 deri 37 – Kartela e regjistrimit, *Fotografi, Kamion Kiper, regjistrim I skaduar 08.01.2022*

Faqe 38, 39 – Libreza, *Kamionetë dubelkabinë 4 Dyer (05 – 918 – DT) - ky dokument nuk është kërkuar në DT.*

Faqe 40 – Libreza, *Kamionetë dubelkabinë me 4 Dyer (05 – 214 – FJ) - ky dokument nuk është kërkuar në DT.*

Faqe 41 – Faturë për *makinë për përzirjen e llaqit, gypa gome, rotor, stator. - ky dokument nuk është kërkuar në DT.*

Dokumenti: 11. MARRËVESHJE PËR PERDORIMIN E MJETETE PUNES korpa-TAHIR ZHARKU

Kjo marrëveshje është për **corpën me targa 670 – KS – 927**. Ky automjet **nuk ka regjistrim valid** I cili ka skaduar me datën 20.02.2021.

Dokumenti: 13. MARRËVESHJE PËR PERDORIMIN E raketes

Ky dokument I plotëson kushtet për **Makinë për shpime horizontale.**

Me datën 12.04.2022 ju keni kërkuar sqarim nga “PLUS TRADE L.L.C” për munges të deshmive për dokumentacion të paisjeve. Në përgjigjen e kompanisë “PLUS TRADE L.L.C” përsëri ka dërguar librezën e Korpës së njëjtë (670 – KS – 927) me datë të skaduar të regjistrimit 20.02.2021.

Figura 1. Para Sqarimit

**Dokumenti: 11. MARRËVESHJE
PËR PERDORIMIN E MJETETE
PUNES korpa-TAHIR ZHARKU**

*nuk ka afat të regjistrimit (20.02.2021)

The image displays three copies of a vehicle registration certificate (CRA/YPB/VRC) for a vehicle with license plate 670-KS-327. The top row shows three identical copies of the certificate, each with a red box highlighting the registration date (19-02-2019) and a red arrow pointing to the registration date field. The bottom row shows three identical copies of the certificate, each with a red box highlighting the registration date (19-02-2019) and a red arrow pointing to the registration date field.

A	Numri i regjistrimit	670-KS-327
B <th>Data e regjistrimit</th> <td>19-02-2019</td>	Data e regjistrimit	19-02-2019
C <th>Emri i drejtuesit</th> <td>Zharku</td>	Emri i drejtuesit	Zharku
D <th>Emri i drejtuesit</th> <td>Tahir</td>	Emri i drejtuesit	Tahir
E <th>Emri i drejtuesit</th> <td>Ar'Emrudo Frangoz' Kacani</td>	Emri i drejtuesit	Ar'Emrudo Frangoz' Kacani
F <th>Data e regjistrimit</th> <td>19-02-2019</td>	Data e regjistrimit	19-02-2019
G <th>Emri i drejtuesit</th> <td>VV</td>	Emri i drejtuesit	VV
H <th>Emri i drejtuesit</th> <td>LJ</td>	Emri i drejtuesit	LJ
I <th>Emri i drejtuesit</th> <td>35</td>	Emri i drejtuesit	35
J <th>Emri i drejtuesit</th> <td>35</td>	Emri i drejtuesit	35
K <th>Emri i drejtuesit</th> <td>35</td>	Emri i drejtuesit	35
L <th>Emri i drejtuesit</th> <td>35</td>	Emri i drejtuesit	35
M <th>Emri i drejtuesit</th> <td>35</td>	Emri i drejtuesit	35
N <th>Emri i drejtuesit</th> <td>35</td>	Emri i drejtuesit	35
O <th>Emri i drejtuesit</th> <td>35</td>	Emri i drejtuesit	35
P <th>Emri i drejtuesit</th> <td>35</td>	Emri i drejtuesit	35
Q <th>Emri i drejtuesit</th> <td>35</td>	Emri i drejtuesit	35
R <th>Emri i drejtuesit</th> <td>35</td>	Emri i drejtuesit	35
S <th>Emri i drejtuesit</th> <td>35</td>	Emri i drejtuesit	35
T <th>Emri i drejtuesit</th> <td>35</td>	Emri i drejtuesit	35
U <th>Emri i drejtuesit</th> <td>35</td>	Emri i drejtuesit	35
V <th>Emri i drejtuesit</th> <td>35</td>	Emri i drejtuesit	35
W <th>Emri i drejtuesit</th> <td>35</td>	Emri i drejtuesit	35
X <th>Emri i drejtuesit</th> <td>35</td>	Emri i drejtuesit	35
Y <th>Emri i drejtuesit</th> <td>35</td>	Emri i drejtuesit	35
Z <th>Emri i drejtuesit</th> <td>35</td>	Emri i drejtuesit	35

Figura 2. Pas Sqarimit

Për pergjigje e kërkesës për sqarim

*I njeiti document vetem pa ngjyra. Nuk ka afat 20.02.2021



Poashatu OE "PLUS TRADE L.L.C.", në sqarimin e ofruar, ka dërguar edhe një marrveshje me ERPOWER SH.P.K për korpën me targa 06 – 446 – DE. **Data e marrëveshjes është 12.04.2022, pra pas hapjes së ofertave me 16.03.2022.** Me këtë rast është autoriteti kontraktues ka shkelur **neni 39. Sqarimi I tenderëve.**

39. Sqarimi i Tenderëve

39.3 Megjithatë, lejohet që një autoritet kontraktues **gjatë vlerësimit** të kërkojë dhe të marrë informacione apo dokumente, të cilat mungojnë në aplikacion/tender. Këto dokumente, megjithatë, në mënyrë objektive duhet të prezantojnë **prova të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme pasqyrojnë gjendjen ekzistuese para datës së publikimit të Njoftimit për kontratë.**

Pas hapjes dates se hapjes se tenderit.

MARRËVESHJE PËR SHFRYTËZIMIN E MJETVE TË PUNËS

E lidhur në Ferizaj, më datë 12.04.2022, në mes:

1. Kompanisë "PLUS TRADE L.L.C.", me seli në Ferizaj me numër unik identifikues: 811451864, të cilin e përfaqëson z. Përparim Delloshi, Drejtor Ekzekutiv i Kompanisë, në njërin anë si Marrësi,
- Dhe
2. "ERPOWER SH.P.K." me seli në Viti, me numër unik identifikues 810678500, të cilën e përfaqëson Drejtori z. Sabri Zajnullahu, në anën tjetër si Dhënësi

Lënda e kompanisë

Qëllimi i kësaj kontrate është marrje në shfrytëzim të makinerisë ndërtimore të punës me specifikacionet si më poshtë:

KAMION me Korpë të markës NISSAN

"ERPOWER SH.P.K." i bëjnë kompanisë "PLUS TRADE L.L.C.", të shfrytëzojë mjete të punës për projektet e caktuara.

bashkëpunimi lidhet me qëllime të pjesëmarrjes në tenderin me titull: "Ndërtimi i rrjetit të ndriqimit publik Lot1 Në fshatin Mirenë ;Lot 2 Në fshatin Teqe"

Nr i prokurimit : 613-22-983-5-2-1

E PRANUAR NGA:
Për Dhënësin:
"ERPOWER SH.P.K."

Nënshkrimi: 

Për Marrësin:
"PLUS TRADE L.L.C."

Nënshkrimi: 

Autoriteti kontraktues ka pranuar si dokument valid një marrveshje të nënshkruar me datën 12.04.2022 edhe pse hapja e tenderit ka qenë përparësisht një muaj më parë me datën 16.03.2022. Pra, OE “PLUS TRADE L.L.C” ka ndërruar korpen me regjistrim të skaduar duke lidhur një marrveshje të re për tjetër Korpë pas datës së hapjes së ofertës. Këtu kemi të bëjmë me shkeljen e **Nenit 59 të LPP – Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi I tenderëve ku ceket: Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohej ose pranohet nga autoriteti kontraktues ose të ofrohet nga një tenderues.**

Poashtu, autoriteti kontraktues ka kërkuar sqarim nga OE “PLUS TRADE L.L.C” **kompresor për thyerja të pjesëve të forta.** Autoriteti kontraktues nuk ka të drejtë të kërkojë dokumentacione/dëshmi për makineri nese ato nuk janë paraqitur në listën fillestare. OE “PLUS TRADE L.L.C” nuk e ka në list **kompresor për thyerja të pjesëve të forta.**

Neni 59
Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

1. Autoriteti kontraktues mundet që me shkrim të kërkojë nga një tenderues që të sigurojë një sqarim me shkrim mbi cilindo nga aspektet e tenderit të tij, në mënyrë që të bëhet ekzaminimi, vlerësimi ose krahësimi i tenderëve. Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohej ose pranohet nga autoriteti kontraktues ose të ofrohet nga një tenderues.
 2. Autoriteti kontraktues nuk mund të ndryshojë asnjë aspekt të një tenderi. Tenderuesit janë përgjegjës për të siguruar saktësinë e tenderëve të tyre.
-

Me këtë rast është shkelur **Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi I Tenderëve**, sepse këtu kemi ndryshim material duke shtuar një dokument që nuk ka qenë as në listën e paisjeve.

Sipas kësaj logjike të AK, operatorët ekonomik nuk kanë nevojë të humbin kohë për të siguruar paisjet para hapjes së ofertës, mirëpo do të dorëzohen pasi që AK të kërkojë sqarime gjë që është jashtëligjore.

Pra, në dokumentacionin e “PLUS TRADE” L.L.C mungojnë **Kamion, Cilinder, Kompresor për thyerje, Autokorpë.**

Sa i përket kësaj qështje AK nuk ka arsyetuar vendimin e saj. Përgjigja e AK është:

ANKESA PER OE PLUS TRADE LLC

- Pretendimi juaj i parë:

OE qe eshte renditur si i pasuksekshem, si deshmi ka paraqitur mjetet e punes jashte kerkesave te AK, komisioni per vlersim te ofertave merr per baze vetem kerkesat e parashtruara nga AK, dhe nuk ka paraqitur ndonje problem pse ka mjete me shume se qe eshte kerkuar.

Ky Pretendim i juaji eshte i Pa Bazuar.

Askund nuk e arsyeton se ku gjenden Kamioni, Cilindri, Kompresori për thyerje dhe Autokorpa.

Kërkesa 2: b).Një gjeodet bachelor apo master i licencuar se paku 5

Dëshmia 2: Gjeodeti te deshmohet me CV, Diplome dhe Licence per matje gjeodezike me afat,

OE “PLUS TRADE L.L.C” ka paraqitur një marrëveshje me OE “GEO TOP SH.P.K”. Kjo nuk është e lejueshme sipas LPP. Në këtë rast duhet të krijohet Konzorciumi në e-prokurim dhe jo një marrëveshje bashkpunimi. Në rast kur një kompani nuk mund të përmbush të gjitha kriteret atëhere mund të krijoj konzorcium dhe jo marrëveshje.

OE “PLUS TRADE L.L.C” nuk ka paraqitur diplomen dhe CV e gjeodetit Fisnik Ismaili.

Për këtë çështje AK nuk ka kthyer përgjigje.

3.Certifikata Enec, raporti i mbrojtjes IP se diodes, dhe raporti i mbrotjes IK ndaj goditjeve (te noterizuara)

OE “Plus Trade” te dokumenti 12. Certifikatat e noterizuaraka paraqitur vetem çertifikaten ENEC që është 7 faqe si dhe deklaraten e konformitetit “Declaration of Conformity” (nuk është kërkuar në dosje të tenderit. Pra, mungon Raporti IP dhe IK.

Njësoj sikur OE “N.SH “M.V.R Elektromontues”, edhe kompania “Plus Trade SH.P.K” ka paraqitur çertifikaten ENEC në emër të Elektrostubllës. Për të shfrytëzuar këtë dokument “Anesi SH.P.K” ka marrë një Autorizim nga Elektrostublla. Ky autorizim është I pavlefshem sepse Elektrostublla nuk eshte perfaqesues I Zumtobel Group per Kosove ashtu siç është treguar më sipër.

Rikapitullim.

1. **“N.SH “M.V.R Elektromontues”** – mungon **Kamioni**, mungon **Raporet IP dhe IK** dhe **Autorizimi nga Elektrostublla është I pavlefshëm** sepse Elektrostublla nuk është përfaqësues i kompanisë “Zumtobel Lighting GmbH/Thorn”.
2. **“Anesi” SH.P.K** - mungon **Kamioni me kran** dhe **Autorizimi nga Elektrostublla është I pavlefshëm** sepse Elektrostublla nuk është përfaqësues i kompanisë “Zumtobel Lighting GmbH/Thorn”.
3. **“PLUS TRADE L.L.C”** – mungon **Kamion, Cilinder, Kompresor per thyerje, Autokorpë**, mungon **Konzerciumi me OE “GEO TOP SH.P.K”** (ka paraqitur marreveshje bashkepunimi dhe jo konzercium qe kerkohet ne e-prokurim, **Gjeodeti nuk ka diplome dhe CV** dhe **Autorizimi nga Elketrostublla është I pavlefshëm** sepse Elektrostublla nuk është përfaqësues i kompanisë “Zumtobel Lighting GmbH/Thorn”.

Siç edhe mund ta vëreni, kjo kërkesë për rishqyrtim ka zbërthyer fletë për fletë dokumentacionin e kompanive duke evidentuar mungesë të paisjeve të kërkuara në doseën e tenderit. Me këtë rast AK ka shkelur ligjin e prokurimit publik duke shpallur fitues një kompani pa i plotësuar kriteret e kërkuara.

Komisioni nuk ka bërë vlerësim të saktë të tenderit. Ata kan shpallur fitues kompanitë të cilat nuk i kanë përmbushur kërkesat teknike dhe profesionale.

Përgjigja e AK për kete ankese lë shumë për të dëshiruar sepse askund nuk arsyeton vendimin e tij.

Komisioni është dashur të verifikoj autorizimin nga Elektrostublla, dhe jo të marrë të mirëqenë si të tillë. **Elektrostublla** nuk është përfaqësues i **“Zumtobel Lighting GmbH/Thorn”** dhe nuk ka të drejtë të lëshoj Autorizim në emër të tyre. Ne email me te cilen kemi komunikuar për të verifikuar këtë autorizim jeni të bashkangjitur edhe ju si Autoritet Kontraktues si dhe Krpp.

Pra, Autorizmet e lëshuara nga Elektrostublla nuk jane valide sepse Elektrostublla nuk eshte perfaqesues i Zumtobel Group. Për këtë çështje AK e ka marr të pabazuar duke u përgjigjur se nuk e ka për detyrë të verifikoj legjitimitetin e dokumentave. Kjo edhe mund të jetë e vërtetë në rast kur AK nuk ka informacione të tjera, mirëpo meqense ne kemi paraqitur fakte rreth këtyre dokumentave AK e ka për detyrë të reagoj. Kjo thuhet edhe te neni 24 – pika 3.

Neni 24

Përgjegjësia për Inicimin dhe Ushtrimin e Rregullt të Aktiviteteve të Prokurimit

1. Inicimi i rregullt i një aktiviteti të prokurimit është përgjegjësi e ZKA, ZKF dhe Zyrtarit Autorizues të autoritetit kontraktues siç është përcaktuar në nenet 9 dhe 22 të këtij ligji.

2. Pas inicimit të aktivitetit të prokurimit nga ZKA, ZKF dhe Zyrtari Autorizues, ushtrimi i rregullt i aktivitetit të prokurimit është përgjegjësi e Zyrtarit të Prokurimit të autoritetit kontraktues, përveç rasteve kur APP merr ose i jepet përgjegjësia për ushtrimin e aktivitetit të prokurimit sipas këtij ligji, atëherë Zyrtari i Prokurimit i APP-së është përgjegjës për ushtrimin e rregullt të aktivitetit të prokurimit.

3. Të gjithë funksionarët, zyrtarët, punonjësit, shërbyesit civil dhe këshilltarët e një autoriteti kontraktues janë individualisht përgjegjës që të raportojë të gjitha shkeljet e dyshuara të këtij ligji në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

Te bashkangjitur do te ju dergojme komplet komunikimin me Email me kompanine Zumtobel Group ku per shkak te transparences CC jeni: komuna e Lipjanit si dhe Krpp.

Kerkojme nga OSHP qe kete autorizim nga Elektrostublla ta anuloj sepse Elektrostublla nuk eshte perfaqesues i ZUMTOBEL GROUP. Kete e vertetoni me email e paraqitur si dhe duke u future ne webfaqen e ZUMTOBEL GROUP.

Ju kujtojmë se antarët e komisionit duhet të respektojnë: **RREGULLAT dhe UDHËZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK**

40. Krijimi i Komisioneve Vlerësuese të Tenderëve

Secili anëtar do të nënshkruaj deklaratën duke përdorur formën standarde të aprovuar nga KRPP "Deklaratën nën Betim" që deklaron që ai/ajo do të kryej detyrën e vlerësimit në mënyrë të sinqertë dhe me fisnikëri në pajtim me LPP. Të gjithë anëtarët e Komisionit Vlerësues marrin përgjegjësi të plotë individuale për vlerësimin e kryer të ofertës për sa i përket vlerësimit teknik te ofertës.

Pra secili antarë është individualisht përgjegjës për vlerësimin e ofertës.

Kerkojme nga OSHP që ta analizoj detalisht këtë ankesë dhe ta vlerësoj drejt këtë aktivitet të prokurimit.

Kerkojme që të anulohet vendimi I AK dhe lënda të kthehet ne rivlersim. Te respektohet Neni 28 Specifikimet teknike dhe Neni 52 Kriteret per dhenien e Kontrates.

KRITERET PËR VLERËSIM

Kërkesat e përshtatshmërisë profesionale

<p>III.2.1) Kërkesat e përshtatshmërisë:</p> <p>Kërkesa 1 Operatori Ekonomik duhet të përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP), Ligji nr 04 L-42. LPP mund të shkarkohet nga http://krpp.rks-gov.net</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>Evidenca 1 Një deklarata e shkruar nën Betim, e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formën në Aneksin 2. Dëshmitë lidhur me kërkesat e pranueshmërisë do të kërkojnë nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues ka ndër mend që t'ia jap kontratën. Këto dokumente duhet të dorëzohen nga tenderuesi para dhënies së kontratës. Në rast të dështimit të dorëzimit të këtij dokumenti, tenderi në fjalë do të refuzohet. Dokumentet të cilat do të kërkojnë si dëshmi për përmbushje të kërkesave të pranueshmërisë janë me se vijon:</p> <p>a. Për situatën referuar pikës 6.2 [a,b, c,d, e dhe f] dhe pikës 6.3 [a,b dhe d], vërtetim i lëshuar nga gjykata kompetente apo autoritetet administrative të vendit të themelimit të tenderuesit. b. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (kontributi i sigurimit social), i dhe k] certifikate të lëshuar nga autoriteti kompetent apo operatori publik që një situatë e tillë nuk ekziston. c. Për situatën referuar pikës 6.3 [h (tatimit)], vërtetim i lëshuar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të operatorit ekonomik, se operatori ekonomik në fjalë nuk është delikuent (shkelës) në pagesën e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit [para datës së publikimit të Njoftimit të Kontratës]</p>
<p>III.2.2) Përshtatshmëria profesionale:</p> <p>1.Regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit</p> <p>2.Certifikata e numrit fiskal</p>	<p><i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i></p> <p>1.Certifikata e regjistrimit të biznesit – kopje</p> <p>2.Kopja e certifikatës së numrit fiskal</p>

Kërkesat mbi gjendjen ekonomike dhe financiare

III.2.3) Kapaciteti ekonomik dhe financiar:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
--	---------------------------------------

Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional:	<i>Dëshmia e kërkuar dokumentare:</i>
Kërkesa 1 Operatori ekonomik duhet të ofroj dëshmi se ka perfunduar me sukses kontratat për projekte të ngjashme në vlerë minimale për Lot 1. 80.000.€, Lot 2. 50.000.€ në 3 (tri) vitet e shkuara duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat	Dëshmia 1. Nje liste e kontratave e nenshkuar dhe vulosur nga OE ku do të bëhet përshkrimi me këto informata titullin e kontratës, klientin, datën e fillimit të kontratës, datën e përfundimit të kontratës, vlerën e kontratës, Referencat apo pranimin teknik kopje për
	kontratat e prezentuara për projekte të ngjashme, Nëse kontrata me reference është me kompani private të deshmohet me transaksion bankar (deshmi që është kry pagesa). Referencat apo pranimet teknike duhet të jenë në 3 (tri) vitet e shkuara, duke filluar nga data e publikimit të Njoftimit për Kontrat
Kërkesa 2 Stafin profesional. a).Min. Nje inxhinier master apo bachelor i diplomuar i Elektroteknikës të jetë i angazhuar edhe në të drejtë të menagjerit për këtë projekt, minimum 5 vite përvojë pune pas diplomimit. b)Min. b).Një gjeodet bachelor apo master i licencuar së paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit. c) Min 5 puntor	Dëshmia 2. Lista e stafit duhet të dorëzohet e nenshkuar dhe e vulosur nga OE që duhet të përmbajë emrin, mbiemrin, profesionin dhe pozicionin. a).Vendimi apo deklarata për emrimin e menagjerit të projektit e nenshkuar dhe e vulosur nga OE. b).Për stafin profesional pika a).të deshmohen me CV dhe Diploma, për pikën b). Gjeodeti të deshmohet me CV, Diplome dhe Licence për matje gjeodezike me afat, për pikën c)., për të gjithë stafin duke përfshirë edhe puntorët kontratat e punës ose parakontrata për këtë projekt.

<p>Kerkesa 3 Lista e pajisjeve teknike a.Eskavator - min 1 copë b.Kamion - min 1 copë e. Cilinder per ngjeshjen (min 1 cope), d.Makine per shpim horizontal nen rruge per vendosjen e kabllave min 1 cope, e.Kompresor per thyrje te pjeseve te forta (beton,asfalt) min 1 copë, e)Auto korpe (shporte) min 1 cope, f)Kamion Auto Kran min 1 cope</p>	<p>Deshmia 3.Lista e paisjeve e nenshkruar dhe vulosur nga OE, Pajisjet të cilat regjistrohen duhet të dëshmohen me librezën e regjistrimit (librezat duhet te jene me validitet), ndërsa pajisjet tjera, OE duhet ti dëshmoj me një dokument për pronësinë e pajisjeve (DUD apo fature etj). Ne rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët</p>
<p>4.Certifikata Enec, raporti i mbrojtjes IP se diodes, dhe raporti i mbrotjes IK ndaj goditjeve (te noterizuara)</p>	<p>4.Çertifikat ENEC e (noterizuar nga origjinali)rapoti I mbrojtjes IP se diodes(e noterizuar nga origjinali)dhe raporti I mbrojtjes IK ndaj goditjeve(e noterizuar nga origjinali)</p>

RAPORTI I KOMISIONIT VLERËSUES

Komisioni vlerësues rekomandon drejtorin e prokurimit për dhënie të kontratës llot 1 OE”ANESI” SHPK. Llot 2 “NSH M.V.R ELEKTROMONT”.

VENDIMET E MËPARSHME LIDHUR ME RASTET E NGJASHME

N/A

ARSYETIMI PËR DEVIJIM NGA PRAKTIKA E MËPARSHME

N/A

PËRGJIGJE NË PRETENDIMET ANKIMORE TË OE

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankuesit të parë “Tala Engineering”SHPK & “Rahovica Commerce”SHPK për LOT 1 kundër OE të rekomanduarit “ANESI”SHPK:

Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron pretendimet si mëposhtë.

Përgjigje në pretendimin e parë:

Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga OE Tala Engineering SHPK&Rahovica Commerce SHPK me nr të lëndës 118/22 dhe Termomontimi SHPK me nr të lëndës 119/22 lidhur me aktivitetin e prokurimit “Ndërtimi i rrjetit të ndriqimit publik Lot1 Në fshatin Mirenë ;Lot 2 Në fshatin Teqe”, me nr. të prokurimit: 613-22-983-5-2-1, iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) –KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN.

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të parë të OE ankues kundër OE të rekomanduarit për LOT 1 sqaron se, AK në DT ka kërkuar që makinerit dhe paisjet nëse nuk janë në pronësi të OE, atëherë të dëshmohej marrëveshja mbi qiramarrjen për projektin në fjalë dhe me validitet sipas kohëzgjatjes së kësaj kontrate, kurse në ofertën e OE të rekomanduarit gjendet një marrëveshje, mirpo nuk është konform kërkesës së AK-së për faktin se marrëveshjet nuk janë për projektin në fjalë, dhe si e tillë pretendimi **i OE ankues gjendet i bazuar. (shih dëshmitë tek pretendimet e OE ankues);**

Përgjigje në pretendimin e dytë, tretë dhe katërt:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të dytë, tretë dhe katërt të OE ankues kundër OE të rekomanduarit sqaron se, OE i rekomandur në ofertë ka të bashkangjitur makineri dhe pajisje të cilat nuk kanë validitet në librezë, gjerësa AK në DT ka kërkuar që librezat duhet të jenë me validitet, përkundër që validitetin konsideroj se nuk duhet të vendoset si kërkesë në DT për faktin se asnjë automjet, makineri që lëvizë nuk mund të dalë në qarkullim nëpër rrugë dhe si e tillë validiteti është diskrecion i organeve të rendit- policisë. Mirpo meqë AK ka vendosur kërkesën e tillë në DT, **atëherë pretendimet e OE ankues gjenden të bazuara. (Shih dëshmitë e bashkangjitura më lartë tek pretendimet e OE ankues);**

Përgjigje në pretendimin e pestë:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të pestë të OE ankues kundër OE të rekomanduarit sqaron se, AK në DT ka kërkuar që siguria e tenderit të ndahet në LOT 1 -1000 euro dhe LOT 2-1000 euro, dhe meqenëse OE i rekomanduar ka dorëzuar ofertën në dy lotet, atëherë edhe sigurimi duhet të bashkangjitet për dyjat, pasi që ky aktivitet i prokurimit është i ndarë në dy lote, dhe si e tillë **pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Pretendimi 5:**Ne dosjen e tenderit ka kerkuar sigurimin e tenderit si ne vijim:**

Siguria e tenderit	13.1	A është e nevojshme siguria e tenderit: Po <input checked="" type="checkbox"/> Jo <input type="checkbox"/> <i>Nëse kërkohet sigurimi i tenderit:</i> Tenderuesi duhet të depozitoj sigurimin e tenderit.
	13.2	Per Lot 1- 1000.€ Per Lot 2- 1000.€ Vlefshmëria e sigurisë së tenderit në ditë 90 apo muaj sigurimi i tenderit mund të dorëzohet i skanuar së bashku me oferte, ndërsa forma origjinale e sigurimit të tenderit do të kërkohet të dorëzohet nga një tenderues të cilin autoriteti kontraktues ka për qëllim që ta shpërblejë me kontratë. Mos dorëzimi i formës origjinale të sigurimit të tenderit shpije në zbatimin e nenit 99.2 të LPP-se

Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT	<u>Refuzo tenderin</u> pa kërkuar informacion të mëtejshëm	57
--	--	----

Përgjigje në pretendimin e gjatë:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të gjashtë të OE ankues kundër OE të rekomanduarit sqaron se, AK në DT ka kërkuar që të bashkangjitet Certifikata ENC, po ashtu edhe raporti mbrojtës IP së diodës, dhe raporti i mbrojtjes IK ndaj goditjeve (të noterizuara), kurse OE i rekomanduar në ofertë nuk ka të bashkangjitur kufar raporti sipas kërkesës së AK-së, dhe si e tillë **pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin e shtatë:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të shtatë të OE ankues kundër OE të rekomanduarit sqaron se, sa i përket **Autorizimit** të OE të rekomanduarit nga **përfaqësuesi për Kosovë ‘Elektrostublla’ SHPK**, dhe dëshmime të bashkangjitura nga OE ankues mbi përgjigjen e kompanisë **“Zumtobel lightning GMBH/Thorn”** konsideroj se AK duhet të marrë parasysh pretendimin dhe të kërkojë sqarime personalisht nga kompania në fjalë në mënyrë që ti vërtetojë dëshmitë e OE ankues, **andaj si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Përgjigje në pretendimet e OE ankues kundër Operatorit ekonomik NSH“MVR ELEKTROMONTUES” për LOT 1:

Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron pretendimet si mëposhtë;

Përgjigje në pretendimin e parë të OE ankues kundër OE NSH“MVR ELEKTROMONTUES”:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të parë të OE ankues sqaron se, AK në DT ka kërkuar që makinerit dhe paisjet nëse nuk janë në pronësi të OE, atëherë të dëshmohet marrëveshja mbi qiramarrjen për projektin në fjalë dhe me validitet sipas kohëzgjatjes së kësaj kontrate, kurse në ofertën e OE “MVR ELEKTROMONTUES” gjenden marrëveshjet, mirpo nuk janë konform kërkesës së AK-së për faktin se marrëveshjet nuk janë për projektin në fjalë, dhe si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Përgjigje në pretendimin e dytë të OE ankues kundër OE NSH“MVR ELEKTROMONTUES”:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të dytë të OE ankues sqaron se, AK në DT ka kërkuar që siguria e tenderit të ndahet në LOT 1 -1000 euro dhe LOT 2-1000 euro, dhe meqenëse Operatori Ekonomik në fjalë ka dorëzuar ofertën në dy lotet, atëherë edhe sigurimi duhet të bashkangjitet për dyjat, pasi që ky aktivitet i prokurimit është i ndarë në dy lote, dhe si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Sigurimi i tenderit nuk përmban kushtet e përcaktuara sipas formës standarde pjese e DT	Refuzo tenderin pa kërkuar informacion të mëtjshëm	57
---	--	----

Përgjigje në pretendimin e tretë të OE ankues kundër OE NSH“MVR ELEKTROMONTUES”:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të tretë të OE ankues sqaron se, në ofertën e Operatorit ekonomik nuk ka të bashkangjitur makinerinë sipas kërkesës së AK-së, dhe si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Përgjigje në pretendimin e katërt të OE ankues kundër OE NSH“MVR ELKTROMONTUES”:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të katërt të OE ankues sqaron se, operatori ekonomik në ofertë ka të bashkangjitur vetëm një faturë për makinën për shpim horizontal nen rrugë, dhe si e tillë **pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin e pestë të OE ankues kundër OE NSH“MVR ELKTROMONTUES”:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të pestë të OE ankues sqaron se, sa i përket **Autorizimit** të operatorit ekonomik në fjalë nga **përfaqësuesi për Kosovë ‘Elektrostublla’SHPK**, dhe dëshmime të bashkangjitura nga OE ankues mbi përgjigjen e kompanisë **“Zumtobel lightning GMBH/Thorn”** konsideroj se AK duhet të marrë parasysh pretendimin dhe të kërkoj sqarime personalishtë nga kompania në fjalë në mënyrë që ti vërtetoj dëshmitë e OE ankues, **andaj si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Përgjigje në pretendimet e OE ankues kundër Operatorit ekonomik NSH“PLUS TRADE”& NNP”ATC COM”SHPK për LOT 1:

Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron pretendimet si mëposhtë;

Përgjigje në pretendimin e parë të OE ankues kundër Operatorit ekonomik NSH“PLUS TRADE”& NNP”ATC COM”SHPK:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të parë të OE ankues sqaron se, lidhur me makinerinë kamion me vinc për të cilën AK ka kërkuar sqarime shtesë, ku operatori ekonomik në fjalë ka bashkangjitur dëshmi marrëveshjen e themeluar pas hapjes së ofertave, e cila dëshmi nuk mund të merret e mirëqenë për faktin se paraqet ndryshim material, **andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin e dytë të OE ankues kundër Operatorit ekonomik NSH“PLUS TRADE”& NNP”ATC COM”SHPK:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të dytë të OE ankues sqaron se, në ofertën e operatori ekonomik në fjalë nuk gjendet në listën e paisjeve kjo makinë, dhe si e tillë **pretendim i OE ankues gjendet i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin e tretë të OE ankues kundër Operatorit ekonomik NSH“PLUS TRADE”& NNP”ATC COM”SHPK:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të tretë të OE ankues sqaron se, në ofertën e operatori ekonomik në fjalë gjenden disa libreza për kamion, gjerësa përkundër që validitetin konsideroj se nuk duhet të vendoset si kërkesë në DT për faktin se asnjë automjet, makineri që lëvizë nuk mund të dal në qarkullim nëpër rrugë dhe si e tillë validiteti është diskrecion i organeve të rendit- policisë. Mirpo meqë AK ka vendosur kërkesën e tillë në DT, **atëherë pretendimet e OE ankues gjendet i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin e katërt të OE ankues kundër Operatorit ekonomik NSH“PLUS TRADE”& NNP”ATC COM”SHPK:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të katërt të OE ankues sqaron se, në ofertën e operatori ekonomik në fjalë gjendet një marrëveshje me kompanin Geo Top SHPK, mirpo AK në DT ka kërkuar: *Një gjeodet bachelor ose master i licencuar se paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit*, kurse në rastin konkret në ofertë ka të bashkangjitur dokumente të biznesit si dhe licencën të cilat dëshmi nuk janë të mjaftueshme, dhe si e tillë **pretendim i OE ankues gjendet i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin e pestë të OE ankues kundër Operatorit ekonomik NSH“PLUS TRADE”& NNP”ATC COM”SHPK:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të pestë të OE ankues sqaron se, në ofertë OE në fjalë tek listat e paisjeve, nuk ka të bashkangjitur Auto korpe(shporte) siq kërkohet nga AK në DT, dhe si e tillë **pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin e gjashtë të OE ankues kundër Operatorit ekonomik NSH“PLUS TRADE”& NNP”ATC COM”SHPK:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të gjashtë të OE ankues sqaron se, sa i përket **Autorizimit** të operatorit ekonomik në fjalë nga **përfaqësuesi për Kosovë ‘Elektrostublla’SHPK**, dhe dëshmive të bashkangjitura nga OE ankues mbi përgjigjen e kompanisë **“Zumtobel lightning GMBH/Thorn”** konsideroj

se AK duhet të marrë parasysh pretendimin dhe të kërkoj sqarime personalishtë nga kompania në fjalë në mënyrë që ti vërtetoj dëshmitë e OE ankues, **andaj si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankuesit të dytë “TERMOMONTIMI”SHPK për LOT 2 kundër OE të rekomanduarit NSH“MVR ELEKTROMONTUES”:

Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron pretendimet si mëposhtë.

Përgjigje në pretendimin e parë të OE ankues kundër OE NSH“MVR ELKTROMONTUES”:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të parë të OE ankues sqaron se, AK në DT ka kërkuar që makinerit dhe paisjet nëse nuk janë në pronësi të OE, atëhere të dëshmohet marrëveshja mbi qiramarrjen për projektin në fjalë dhe me validitet sipas kohëzgjatjes së kësaj kontrate, kurse në ofertën e OE “MVR ELEKTROMONTUES” përkundër faktit që në listë ka shenuar që posedon kamion, mirpo nuk ka bashkangjitur dëshmi, dhe si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.

Përgjigje në pretendimin e dytë të OE ankues kundër OE NSH“MVR ELKTROMONTUES”:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të dytë të OE ankues sqaron se, sa i përket **Autorizimit** të operatorit ekonomik të rekomanduar nga **përfaqësuesi për Kosovë ‘Elektrostublla’SHPK**, dhe dëshmime të bashkangjitura nga OE ankues mbi përgjigjen e kompanisë **“Zumtobel lightning GMBH/Thorn”** konsideroj se AK duhet të marrë parasysh pretendimin dhe të kërkoj sqarime personalishtë nga kompania në fjalë në mënyrë që ti vërtetoj dëshmitë e OE ankues, **andaj si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin e tretë të OE ankues kundër OE NSH“MVR ELKTROMONTUES”:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të tretë të OE ankues sqaron se, lidhur me paramasën e OE të rekomanduarit ku OE ankues pretendon se në disa pozicione OE i rekomanduar ka paraqitur cmime abnormalishtë ulëta, si rrjedhojë AK lidhur me këto cmime duhet të kërkoj sqarime konform rregullave për

tenderët abnormalishtë të ulët. **Dhe si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankuesit të dytë “TERMOMONTIMI”SHPK për LOT 2 kundër Operatorit Ekonomik SHPK“ANESI”:

Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron pretendimet si mëposhtë.

Përgjigje në pretendimin e parë të OE ankues kundër OE SHPK“ANESI”:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të parë të OE ankues sqaron se, lidhur me mungesën e kamionit me kran, në ofertën e operatorit ekonomik gjendet ky kamion në marrëveshjen mbi qiramarrje, e cila marrëveshje poashtu nuk është konform kërkesës së AK-së për faktin se marrëveshjet nuk janë për projektin në fjalë, ndërsa sa i përket validitetit konsideroj se nuk duhet të vendoset si kërkesë në DT për faktin se asnjë automjet, makineri që lëvizë nuk mund të dalë në qarkullim nëpër rrugë dhe si e tillë validiteti është diskrecion i organeve të rendit- policisë. Mirpo meqë AK ka vendosur kërkesën e tillë në DT, **atëherë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin e dytë të OE ankues kundër OE SHPK“ANESI”:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të dytë të OE ankues sqaron se, lidhur me **Autorizimin** e operatorit ekonomik nga **përfaqësuesi për Kosovë ‘Elektrostublla’SHPK**, dhe dëshmime të bashkangjitura nga OE ankues mbi përgjigjen e kompanisë **“Zumtobel lightning GMBH/Thorn”** konsideroj se AK duhet të marrë parasysh pretendimin dhe të kërkojë sqarime personalishtë nga kompania në fjalë në mënyrë që ti vërtetojë dëshmitë e OE ankues, **andaj si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar**

Përgjigje në pretendimet ankimore të OE ankuesit të dytë “TERMOMONTIMI”SHPK për LOT 2 kundër Operatorit Ekonomik ”PLUS TRADE L.L.C”:

Ekspertja Shqyrtuese pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës sqaron pretendimet si mëposhtë.

Përgjigje në pretendimin e parë të OE ankues kundër OE “PLUS TRADE L.L.C”:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të parë të OE ankues sqaron se, lidhur me makinerinë kamion me vinc e cila nuk ka validitet në librezë dhe për të cilën AK ka kërkuar sqarime shtesë, ku operatori ekonomik në fjalë ka bashkangjitur dëshmi marrëveshjen e themeluar pas hapjes së ofertave, e cila dëshmi nuk mund të merret e mirëqenë për faktin se paraqet ndryshim material, **andaj pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin e dytë të OE ankues kundër OE “PLUS TRADE L.L.C”:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të dytë të OE ankues sqaron se, lidhur me makineritë e përmendura në pretendim nga OE ankues, konsideroj se pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar për faktin se, OE në fjalë në ofertë ka të bashkangjitur një numër të madhë të paisjeve dhe makinerive, mirpo jo sipas kërkesës së AK-së në DT, dhe si e tillë AK gjatë procesit të rivlerësimit rekomandohet që ti verifikoj edhe njëherë të njejtat.

Përgjigje në pretendimin e tretë të OE ankues kundër OE “PLUS TRADE L.L.C”:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të tretë të OE ankues sqaron se, në ofertën e operatori ekonomik në fjalë gjendet një marrëveshje me kompanin Geo Top SHPK, mirpo AK në DT ka kërkuar: ***Një gjeodet bachelor ose master i licencuar se paku 5 vite përvojë pune pas diplomimit***, kurse në rastin konkret në ofertë ka të bashkangjitur dokumente të biznesit si dhe licencën të cilat dëshmi nuk janë të mjaftueshme, dhe si e tillë **pretendim i OE ankues gjendet i bazuar.**

Përgjigje në pretendimin e katërt të OE ankues kundër OE “PLUS TRADE L.L.C”:

Ekspertja Shqyrtuese sa i përket pretendimit të katërt të OE ankues sqaron se, sa i përket **Autorizimit** të operatorit ekonomik në fjalë nga **përfaqësuesi për Kosovë ‘Elektrostublla’ SHPK**, dhe dëshmime të bashkangjitura nga OE ankues mbi përgjigjen e kompanisë **“Zumtobel lightning GMBH/Thorn”** konsideroj se AK duhet të marrë parasysh pretendimin dhe të kërkoj sqarime personalishtë nga kompania në fjalë në mënyrë që ti vërtetoj dëshmitë e OE ankues, **andaj si e tillë pretendimi i OE ankues gjendet i bazuar.**

Si përfundim, ky aktivitet i prokurimit me titull **“Ndërtimi i rrjetit të ndriqimit publik Lot1 Në fshatin Mirenë ;Lot 2 Në fshatin Teqe”** pas analizimit, krahasimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës, konsideroj se AK nuk ka vlerësuar, ekzaminuar dhe krahasuar ofertat konform LPP-së dhe Rruopp-së.

Andaj sipas sqarimeve dhe përgjigjeve të dhëna në pretendimet e dy operatorëve ankues, rekomandoj Autoritetin Kontraktues që këtë aktivitet të prokurimit ta kthej në rivlerësim, ku procesin e rivlerësimit ta harmonizoj sipas dispozitave ligjore të LPP-së dhe Rruopp-së.

MENDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, Ekspertja Shqyrtuese i propozon Panelit Shqyrtues që ankesat e **OE“Tala Engineering” SHPK&”Rahovica Commerce”SHPK, dhe OE “Termomontimi” SHPK** të aprovohen si të bazuara, të anulohet vendimi i AK-së, si dhe aktiviteti i prokurimit të kthehet në Rivlerësim.

Raporti i ekspertizës t’i dorëzohet:

Autoritetit Kontraktues - **KUVENDI KOMUNAL LIPIJAN**

Panelit Shqyrtues - **OSHP**

OE ankuesit - **OE“Tala Engineering” SHPK&”Rahovica Commerce”SHPK;**
- **OE “Termomontimi” SHPK**